



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

VENDIM

Nr. 13, datë 31.03.2015

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË
U POLIÇAN SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", si dhe Vendimit të KKRR nr.22 datë 14.11.2014 "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2015", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Tarifat për shërbimin e furnizimit me ujë për shoqërinë U Poliçan Sha për vitin 2015 nuk ndryshojnë.
2. Shoqëria U Poliçan Sha do të vazhdojë të aplikojë tarifatat e miratuara me Vendim të KKRR nr 27, datë 18.06.2010 " Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i vlefshëm deri në miratim e tarifave të reja.

**KRYETARI
Avni Dervishi**